

SHOQERIA TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ER-AR CONSTRUCTION" SHPK

Ortak i Vetem

Durres - ALBANIA

AKTI THEMELIMU

Ne Durres ot me daten **20 Nentor 2004** (dymije e kater) une shtetasi shqiptar :
I.MAKSIM CAMI atesia Xhetan,amesia Razije i datelindjes 07.10.1951 shtetas shqiptar
lindur ne Diber banuese ne L.13 Plazh – Durres, Arsim te larte, Ing.Mekanik,duke u bazuar ne :
* Vullnetin tim te lire,te plote dhe te sinqerte, dhe iniciativen e lire private,
* Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
* Ne Ligjin Nr.7638 date 19.II.1992 “ Per Shoqerite Tregtare,
*Ne Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 “ Per Rregjistrin Tregtar”,ne ate Doganor,Fiskal e Tatimor
ne normat e se drejtes tregtare nderkombetare dhe ato te Komunitetit European me anen e ketij
AKTI ,krijoj Shoqerin Tregtare dhe Ortak i Vetem “ E R – A R CONSTRUCTION”Shpk Durres-
Albania.

NENI 1

SHOQERIA formohet nga une Ortaku Vetem me emrin ““ E R – A R CONSTRUCTION” Shpk
Durres-Albania ,emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2


SELIA Qendrore e Shoqerise ““ E R – A R CONSTRUCTION”Shpk eshte ne Durres ne Adresen:
Lagja Nr 13 Plazh-Durres -Albania
Tel./Fax ++ 52 60988
Tel.Celular 0692078214

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes
se Shqiperise si dhe jashte shtetit ne vendet e Komunitetit European,kryesisht **Gjermani,Itali** etj
Me Vendim te Ortakut te vetem,mund te krijohen ose anulohen(ne rast se jane çelur) SELI,
Filiale,Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.
Njesite e tjera Strukturore te Shoqerise,si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur
nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja ,normat e se drejtes
nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4

KAPITALI Themeltar i Shoqerise eshte **100.000 Lek** (njeqindemije) Lek,i formuar dhe
nenshkruar nga une Ortaku i Vetem,i ndare ne **100 kuota**,me vlere nominative **1000 lek/1 kuote**,ku
nje kuote eshte e barabarte me 1 vote me te drejte vendimore.



02.

Ortaku i vetem ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj Kapitali Mjete Xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër te fituar ne rruge te ligjeshme.
Shoqeria pergjigjet vetem me Kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlere dhe derdhja e Kapitalit themeltar te Shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte per **30 vjet**, duke filluar ky afat nga dita e Shpalljes se Vendimit te Gjykates Shkalles se pare TIRANE, per njohjen dhe rregjistrimin e Shoqerise si Person JURIDIK.

Me VENDIM te Ortakut te vetem ,KOHEZGJATJA e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj, dhe ky VENDIM i dergohet menjehere per depozitim Gjykates kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare ne perputhje te plote me Legjislacionin shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti THEMELIMI dhe STATUTIT te saj.

NENI 8

Shoqeria çel Llogari BANKARE ne leke vendi dhe çdo lloj valute ,ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

ORTAKU i vetem dhe ADMINISTRATORI i caktuar prej tij, depozitojne faksimilet e firmave te tyre origjinale ne BANKAT ku eshte çelur llogaria dhe terheqja e pjesve te saj behet kur ÇEKU bankar eshte firmosur nga Ortaku i vetem dhe Administratori i Shoqerise, ne rastin kur Ortaku i vetem cakton nje Administrator dhe vetem me firmen e Ortakut te vetem, kur ky vete kryen njekohesisht dhe detyren e Administratorit te pergjithshem te Shoqerise.

NENI 9

PJESET e Kapitalit THEMELOR, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave te Kodit Civil.

Ortaku i vetem, ka te drejte te transferoj jashte territorit te Republikes Shqiperise pjeserisht apo teresisht KONTRIBUTET e tij perfshire dhe FONDET e Kontributet ne NATYRE.

TRANSFERIMET e pjeseve te Kapitalit Themelor, duhet te jene te vertetuara me AKT Noterial dhe per nje gje te tille ORTAKU vetem duhet te marr paraprakisht VENDIM me shkrim.

SHOQERIA dhe te tretet, duhet te respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 10

SHOQERIA krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregtar ne keto DREJTIME:

1. NDERTIMIN e çdo lloj GODINE nje ose shume kateshe, sikurse jane Pallatet e Banimit Ndertime CIVILE ,Industriale, Turistike, Bujqesore Qendra Biznesi, hotele, Bar-Restorante ,Magazina ,Parkingje, komplekseve te ndryshme turistike, ne zona malore e bregdetare, te depove stacione per karburante e nenprodukteve te tyre si dhe rikonstruksione te ndryshme ndertimore. etj.





03.

2. Ndertimin e Urave, celjen dhe ndertimin e rrugeve te reja, te autostradave te komunikacionit urban dhe interurban, asfaltimin e tyre, si brenda vendit dhe jashte shtetit, kryerjen e veprave te artit dhe mirembajtjen si dhe permiresimin e tyre ne perputhje me infrastrukturen bashkekohore.

3. Punime dhe kanalizime per rrjetet e jashtme dhe te brendeshme te UJESJELLSEVE te qendrave te banimit, ne qytet, Komuna dhe fshatra dhe te çdo rrjeti tjetër te sistemit HIDRIK, sikurse jane ndertimi dhe kryerja e punimeve permiresuese te DIGAVE, Hidrovoreve, ne Centralet Elektrik TEC-et, hapje dhe shtrirje tubacionesh per rjedhjen ne kanalizime te ujrave te bardha dhe te zesa duke shmangur çdo ndotje te Ambientit dhe Mjedisit.

4. Ndertim te Impianteve te Pastrimit te mbeturinave civile dhe industriale, kryerje punimesh per ngritjen dhe restaurimin e rrjetit BONIFIKUES te vaditjes dhe kullimit te tokave, te Stacioneve te Pompimit, perfshire dhe kryerjen e veprave te artit ndertimor te tyre

5. Ngritje dhe venie ne funksionim te POLIGONEVE te ndertimit per prodhimin e materialeve inerte, te betoneve, penobetoneve dhe te çdo materiali ndertimor parafabrikat, si dhe tregetimin e tyre me shumice e pakice, brenda vendit dhe jashte shtetit.

6. NDERTIME Mbrojtese e punime sistemimi kunder grryerjeve lumore, liqenore, detare te rezervuareve pellgmbajtes, kryerje punimesh per germime dheu me mjete te mekanizuara, hapje tunelesh dhe kryerje punimesh avancimi dhe perforcimi ne to, te prodhimeve pilote dhe elementeve te tjere betonarme, prodhim guri per skolierat ne ndertimet PORTUALE, punime çimentimi dhe te injektiveve detare, shtrirje kabllosh e tubacionesh nenujore etj.

Ndertime dhe restaurime te Impianteve te kultivimit artificial te peshkut dhe midhjeve ne ujrat e kripura dhe te embla.

7. Kryerjen e punimeve ne siperfaqet e gjelbera, Pyje, Kullota, Parqe mirembajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane dhe pastrim i siperfaqeve urbane.

8. IMPORT Eksportin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te materialeve te gjithllojshem ndertimore, te teknologjive dhe mjeteve te mekanizuara per nevojat e ndertimit, te paisjeve dhe materialeve hidrosanitare, elektrike, te axhensoreve, dyerve blindate, te prodhimeve prej duralumini e te pjesve te ndryshme te kembimit per çdo makineri apo paisje, si dhe celjen e reparteve dhe linjave te prodhimit per to, brenda vendit e jashte shtetit, si vetem dhe ne kooperim dhe bashkepunim me firma private te Huaja.

9. Import eksportin dhe tregetimin me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale artikujve ushqimore, blektorale, bujqesore, dhe te cdo lloj malli tjetër te lejuar per tregetim.

10. Celjen dhe ushtrimin e aktivitetit te Agjensive Turistike, DETARE dhe Spedicionere, te sherbimit social privat me ane te Hoteleve, Bar-Restoranteve si dhe **TRANSPORT nderkombetar** per **PASAGJER** dhe te mallrave te çdo lloji me mjetet e veta te Komunikacionit tokesor e DETAR.

11. Marrjen pjese ne Panaire kombetare dhe nderkombetare, qe kane te bejne me celjen dhe zhvillimin e biznesit, ne fushen e ndertimit dhe te teknologjise bashkekohore te tij, me qellim jo vetem ekspozimin e games se prodhimeve ndertimore te firmes por dhe per te mundesuar arritjen e marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit te perbashket tregetar me to, si dhe pjesmarrje ne TENDERA brenda e jashte vendit.

NENI 11

Me Vendim te Ortakut te vetem, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortak te tjere, shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjetër tregetare si brenda vendit dhe jashte shtetit

NENI 12

Ortaku i vetem, eshte Organi me i larte Drejtues dhe VENDIMOR i Shoqerise dhe ai ushtron te gjitha kompetencat qe Ligji " Per Shoqerite Tregetare" i njej ASAMBLESE se Ortakeve qe jane krijuar me Ortakeri.

04.

Ortaku i vetem mund t'ja delegoj KOMPETENCAT nje ose me shume Administratoreve te caktuar prej tij ose dhe nje Personi fizik apo Juridik,vendas apo te huaj dhe jashte ortakerise se Shoqerise,mbi bazen e PROKURES,te bere me akt noterial.

NENI 13

Administratore te Pergjithshem te Shoqerise emerohen Ortaku i vetem **Z.MAKSIM CAMI** i datelindjes 07.10.1951 ndersa jashte **ORTAKERIS** dhe pa kontribut financiar ne krijimin e kapitalit themeltar ,bazuar ne te drejten qe lejon neni 50/1 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare",emerohet **Znj.DRITA ISMAIL CAMI** (SESERI) e datelindjes 18.09.1957 banuese ne **L.13 Plazh Durres.**

NENI 14

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 5 ekzemplare me permbejtje dhe vlera te njenjta juridike ne gjuhen shqipe dhe eshte I vlefshem de jure, kur ne te gjithë faqet e tij eshte vene emir,mbiemri dhe firma origjinle e Ortakut Themelues dhe kur autenticitetit te nenshkrimit eshte vertetuar nga noteri.

THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE

"ER-AR CONSTRUCTION" Shpk

ORTAK I VETEM

MIRATUES I KETIJ AKTI THEMELIMI

MAKSIM CAMI



SHOQERIA TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"E R - A R CONSTRUCTION" Shpk

Ortak i Vetem

Durres - ALBANIA

S T A T U T

KREU I:

EMERTIMI - OBJEKTI - SELIA - KOHEZGJATJA

NENI 1

Ne qytetin e Durresit ,sot me daten **20 Nentor 2004** (dymije e kater),dite e Shtune,nga une Ortaku Vetem,shtetasi Shqipetar **MAKSIM XHETAN CAMI** datelindjes 07.10.1951,eshte krijuar Shoqeria Tregtare pergjegjesi te Kufizuar "**E R - A R CONSTRUCTION**"Shpk Durres - Albania.

NENI 2

SHOQERIA Tregtare eshte vendase dhe quhet me emrin "**E R - A R CONSTRUCTION**" Shpk Albania emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj

NENI 3

SELIA Qendrore e Shoqerise "**E R - A R CONSTRUCTION**"Shpk eshte ne Durres ne Adresen:
Lagja Nr 13 Plazh-Durres -Albania
Tel./Fax ++ 52 60988
Tel.Celular 0692078214

NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithë juridiksionin territorial te Republikës se Shqiperise si dhe jashte shtetit,ne vendet e Komunitetit European,kryesisht **Gjermani,Itali** etj
Me Vendim te Ortakut te vetem,mund te krijohen ose anulohen(ne rast se jane çelur) **SELI**, Filiale,Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.

Njesite e tjera Strukturore te Shoqerise,si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja ,normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme

NENI 5

KAPITALI Themeltar i Shoqerise eshte **100.000 Lek** (njqindemije) Lek,i formuar dhe nenshkruar nga une Ortaku i Vetem,i ndare ne **100 kuota**,me vlere nominative **1000 lek /1 kuote** dhe ku 1 kuote eshte e barabarte me 1 vote me te drejte vendimore.

Ortaku i vetem ka pavaresi ligjore,organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj Kapitali Mjete Xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër te fituar ne rruge te ligjeshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me Kapitalin e saj.



NENI 6

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlere dhe derdhja e Kapitalit themeltar te Shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik.

NENI 7

KOHEZGJATJA e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte per 30 vjet, duke filluar ky afat nga dita e Shpalljes se Vendimit te Gjykates Shkalles Pare TIRANE, per njohjen dhe rregjistrimin e Shoqerise si Person JURIDIK.

Me VENDIM te Ortakut te vetem ,KOHEZGJATJA e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj, dhe ky VENDIM i dergohet menjehere per depozitim Gjykates kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

NENI 8

SHOQERIA krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto drejtime

1. NDERTIMIN e çdo lloj GODINE nje ose shumekateshe, sikurse jane Pallatet e Banimit Ndertime CIVILE, Industriale, Turistike, Bujqesore Qendra Biznesi, hotele, Bar-Restorante Magazina , Parkingje, komplekseve te ndryshme turistike, ne zona malore e bregdetare, te depove stacionere per karburante e nenprodukteve te tyre si dhe rikonstruksione te ndryshme ndertimore. etj.

2. Ndertimin e Urave, celjen dhe ndertimin e rrugeve te reja, te autostradave te komunikacionit urban dhe interurban, asfaltimin e tyre, si brenda vendit dhe jashte shtetit, kryerjen e veprave te artit dhe mirembajtjen si dhe permiresimin e tyre ne perputhje me infrastrukturen bashkekohore.

3. Punime dhe kanalizime per rrjetet e jashtme dhe te brendeshme te UJESJELLSEVE te qendrave te banimit, ne qytet, Komuna dhe fshatra dhe te çdo rrjeti tjetër te sistemit HIDRIK, sikurse jane ndertimi dhe kryerja e punimeve permiresuese te DIGAVE, Hidrovorevc, ne Centralet Elektrik TEC-et, hapje dhe shtrirje tubacionesh per rjedhjen ne kanalizime te ujrave te bardha dhe te zesa duke shmangur çdo ndotje te Ambientit dhe Mjedisit.

4. Ndertim te Impianteve te Pastrimit te mbeturinave civile dhe industriale, kryerje punimesh per ngritjen dhe restaurimin e rrjetit BONIFIKUES te vaditjes dhe kullimit te tokave, te Stacioneve te Pompimit, perfshire dhe kryerjen e veprave te artit ndertimor te tyre

5. Ngritje dhe venie ne funksionim te POLIGONEVE te ndertimit per prodhimin e materialeve inerte, te betoneve, penobetoneve dhe te çdo materiali ndertimor parafabrikat , si dhe tregetin e tyre me shumice e pakice, brenda vendit dhe jashte shtetit.


6. NDERTIME Mbrojtese e punime sistemimi kunder grryerjeve lumore, liqenore, detare te rezervuareve pellgmbajtes,, kryerje punimesh per germime dheu me mjete te mekanizuara, hapje tunelesh dhe kryerje punimesh avancimi dhe perforcimi ne to, te prodhimeve pilote dhe elementeve te tjere betonarme, prodhim guri per skolierat ne ndertimet PORTUALE, punime çimentimi dhe te injektiveve detare, shtrirje kabllosh e tubacionesh nenujore etj.

Ndertime dhe restaurime te Impianteve te kultivimit artificial te peshkut dhe midhjeve ne ujrat e kripura dhe te embla.

7. Kryerjen e punimeve ne siperfaqet e gjelbera, Pyje, Kullota, Parqe mirembajtje dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane dhe pastrim i siperfaqeve urbane.

8. IMPORT Eksportin dhe tregetin me shumice dhe pakice te materialeve te gjithllojshem ndertimore, te teknologjive dhe mjeteve te mekanizuara per nevojat e ndertimit, te paisjeve dhe materialeve hidrosanitare, elektrike, te axhensoreve, dyerve blindate, te prodhimeve prej duralumini e te pjesve te ndryshme te kembimit per çdo makineri apo paisje, si dhe celjen e reparteve dhe linjave te prodhimit per to, brenda vendit e jashte shtetit, si vetem dhe ne kooperim dhe bashkepunim me firma private te Huaja.

9. Import eksportin dhe tregetin me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale



03.

artikujve ushqimore,blektorale,bujqesore,dhe te cdo lloj malli tjetër te lejuar per tregetim.

10.Celjen dhe ushtrimin e aktivitetit te Agjensive Turistike ,DETARE dhe Spedicionere,te sherbimit social privat me ane te Hoteleve,Bar-Restoranteve si dhe **TRANSPORT nderkombetar per PASAGJER** dhe te mallrave te çdo lloji me mjetet e veta te Komunikacionit tokesor e DETAR.

11.Marrjen pjese ne Panaire kombetare dhe nderkombetare,qe kane te bejne me çeljen dhe zhvillimin e biznesit,ne fushen e ndertimit dhe te teknologjise bashkekohore te tij,me qellim jo vetem ekspozimin e games se prodhimeve ndertimore te firmes por dhe per te mundesuar arritjen e marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit te perbashket tregetar me to,si dhe pjesmarrje ne TENDERA,brenda e jashte vendit.

NENI 9

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik qe nga data e shpalljes se Vendimit te Gjykates rrethit Tirane per njohjen dhe Rregjistrimin e saj si Person JURIDIK ne Rregjistrin tregetar te asaj Gjykate.

Ushtrimin e Aktivitetit tregetar e fillon pasi te jete rregjistruar dhe paisur me CERTIFIKATAT perkatese ne Organin e Deges Tatim Taksave Durres.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine tregetare ne perputhje me Legjislacionin shqipetar ne fuqi,si ate tregetar,Civil,Doganor,Tatimor,Fiskal dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore specifike per ushtrimin e saj,sipas objektit te veprimtarise se saj, si dhe mbi bazen e Aktit te Themelimit dhe STATUTIT te saj.

KREU II :

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqeria çel Llogari BANKARE ne leke vendi dhe çdo lloj valute ,ne Banka vendase ose te huaja,private apo shtetore,me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

ORTAKU i vetem dhe ADMINISTRATORI i caktuar prej tij,depozitojne faksimilet e firmave te tyre origjinale ne BANKAT ku eshte çelur llogaria dhe terheqja e pjesve te saj behet kur CEKU bankar eshte firmosur nga Ortaku i vetem dhe Administratori i Shoqerise, ne rastin kur Ortaku i vetem cakton nje Administrator dhe vetem me firmen e Ortakut te vetem,kur ky vete kryen njekohesisht dhe detyren e Administratorit te pergjithshem te Shoqerise,

NENI 12

PJESET e Kapitalit THEMELOR,jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave te Kodit Civil.

Ortaku i vetem,ka te drejte te transferoj jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht KONTRIBUTET e tij perfshire dhe FONDET e Kontributet ne NATYRE.

TRANSFERIMET e pjeseve te Kapitalit Themelor,duhet te jene te vertetuara me AKT Noterial dhe per nje gje te tille ORTAKU vetem duhet te marr paraprakisht VENDIM me shkrim.

SHOQERIA dhe te tretet,duhet te respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.



NENI 13

KAPITALI Themeltar i Shoqerise mund te rritet ose zvogelohet, mbi bazen e Vendimit me shkrim qe merr ORTAKU i vetem , i cili nenshkruhet prej tij dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne rregjistrin perkates.....

Cdo VENDIM i Ortakut te vetem per ndryshimin e Kapitalit themeltar i dergohet menjehere Gjykates kompetente qe e ka njohur dhe rregjistruar Shoqerin Person Juridik.....

KREU III:

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE DHE TE DREJTAT DHE DETYRAT E

NENI 14

Ortaku i vetem, eshte **Organi me i larte Drejtues dhe VENDIMOR** i Shoqerise dhe ai ushtron te gjitha kompetencat qe Ligji " Per Shoqerite Tregtare" i njeh ASAMBLESE se Ortakeve qe jane krijuar me Ortakeri.

Ortaku i vetem mund t'ja delegoj KOMPETENCAT nje ose me shume Administratoreve te caktuar prej tij ose dhe nje Personi fizik apo Juridik, vendas ose te huaj dhe jashte ortakerise se Shoqerise, mbi bazen e PROKURES te bere vetem me akt noterial.

NENI 15

Me Vendim te Ortakut te vetem, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjetere tregtare si brenda vendit dhe jashte shtetit.

NENI 16

ORTAKU i vetem i Shoqerise ka dhe keto te drejta dhe detyra kryesore:

* Te marr pjese ne Drejtimin dhe administrimin e gjithanshem te veprimtarise ekonomiko tregtare te Shoqerise dhe te çdo veprimtarie tjetere te saj ,kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

* Te kerkoj dhe ti jepen te gjitha INFORMATAT qe kane te bejne me gjendjen tregtare dhe financiare te veprimtarise se Shoqerise, si dhe i te gjitha dokumentave te perpunuara nga Shoqeria, ato qe kane te bejne me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik te BILANCIT Kontabel apo per çdo llogarie te çelues, si te asaj Likuiduese dhe asaj Rrjedhse.


* Te marr pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne cfaredo Forme apo sasi, sipas kontributit te dhene prej tij.

* Te kryej sherbime per realizmin e objektivave dhe qellimeve te veprimtarise se rregullt ligjore te Shoqerise.

* EMERON dhe shkarkon ne çdo kohe ADMINISTRATORIN e Shoqerise, cakton Ekspertin KONTABEL te autorizuar ose Administratorin e Shoqerise, ne rastin kur ka emeruar nje te tille per pergatitjen dhe nxjerrjen e BILANCIT Vjetor ekonomiko financiar te aktivitetit te Shoqerise, te cilin ata jane te detyruar t'ia paraqesin ORTAKUT mbi bazen e Raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit te tij, ORTAKU i vetem ka dhe te drejte e miratimit vendimor te ketj Bilanci.

Nxjerrja e Bilancit financiar vjetor, mbi bazen e te dhenave dhe rregullave te Kontabilitetit behet brenda 6 MUAJEVE nga mbyllja e vitit financiar.

* ORTAKU i vetem si kryesisht dhe me ane te ADMINISTRATORIT te emeruar prej tij dhe kur ky i fundit eshte i paisur me PROKURE, ushtrojne dhe keto TAGRA(te Drejta) :



05.

Mundesohen per te kryer te gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane te domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures te veprimtarise tregetare te Shoqerise sipas qellimeve dhe objektivave te saj siç mund te jene:

1. Te lidhin Kontrata te ndryshme qe kane per objekt Blerjen, shitjen, kembimin dhe marrjen me qera te PASURIVE te ndryshme (te luajtshme dhe te paluajtshme) si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo te Huaj si dhe me SHTETIN dhe ne rastin e blerjes te Pasurive te Paluajtshme apo marrjen e tyre me QERA per nje kohe mbi 9 VJET, duhet te bejne rregjistrimin ne HIPOTEKAT e ZRPPP te rrethit perkates si per transkriptimin e Pronesise ne favor te tyre apo kalimin e kesaj pasurie ne posedim ligjor.

Cdo blerje e pasurive te mesiperme, konsiderohet dhe si shtese e Kapitalit ne Natyre.

2. Te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjitha Zyrave shtetore dhe Private, BANKAT e çdo niveli etj, qe kane te bejne me GARANCITE, Siper marrjet, marrjen e Kredive, te Siguracioneve dhe Risiguracioneve per jeten dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashte shtetit) kryerjen e veprimeve doganore per zhdoganimin e mallrave te importuara apo deklarimin e atyre te eksportuar te plotesimit ne kohe dhe me rregullsi te dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

Ne rastet kur Veprimet juridike kryhen nga ADMINISTRATORI i emeruar nga Ortaku i Vetem ose personi qe e Perfaqeson ate mbi bazen e PROKURES, keta jane te detyruar qe ne perfundim te realizimit te veprimit perkates te njoftojne menjehere dhe ti japin llogari Ortakut te vetem.

3. ADMINISTRATORI ose PERFAQESUESI me Prokure, jane individualisht pergjegjes ndaj SHOQERISE apo te treteve, per veprime te kryera ne shkelje te ligjeve dhe qe bien ne kundërshtim me kete STATUT dhe per demin e shkaktuar me FAJ, sipas rastiit ,Ortaku i vetem mund te ngrej PADI Civile dhe te kerkoj ndaj tyre shlyerjen e plote te demit te shkaktuar, perfshire dhe fitimin e munguar, duke patur njekohesisht dhe te drejten per te bere kallxim per ndjekje penale ne PROKURORIN e juridiksionit tokesor perkates.

NENI 17

PERFAQESIMI i Shoqerise ,ne mardheniet me te tretet si brenda vendit dhe jashte shtetit si rregull dhe pergjithesisht i perket ORTAKUT te vetem.

NENI 18

Ortaku i vetem dhe ADMINISTRATORI i Shoqerise kane te drejte qe per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te Shoqerise, te marrin ne pune specialiste dhe shtetas te ndryshem madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, duke lidhur KONTRATEN sipas kriterëve qe parashikohen ne Kodin e Punes nefuqi, te miratuar me Ligjin Nr.7961 dt.12.07.1995 dhe shtesat e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin Nr.7703 dt.11.05.1993” Per Sigurimet Shoqerore” si dhe ne perputhje me aktet e tjera ligjore dhe nenligjore per rregullat teknike ne kryerjen e punimeve te ndertimit e ato te disiplinës se punes te caktuara nga ana e punedhënesit.....

KREU IV


BILANCI, te ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 19

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise, mbylleen me daten 31 Dhjetor te çdo viti..

Per nxjerrjen e rezultatit KONTABEL te Shoqerise, mbi bazen e Aktivit dhe Pasivit nga ana e Ortakut te Vetem, caktohet nje EKSPERT Kontabel i AUTORIZUAR.....

EKSPERTI ka per detyre qe te kontrolloj dhe verifikoj te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise Ekonomomiko tregetare te Shoqerise, si ate gjithëvjeter dhe ate ne lidhje me



06.

kontrollet periodike te ushtruara prej tij,per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille nga ana e Ortakut te vetem.

Ne perfundim te Kontrollit,Eksperti kontabel i autorizuar pergatit RAPORTIN me shkrim per nxjerrjen e rezultatit perfundimtar te BILANCIT financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte i detyruar qe t'japaraqes dhe dorztoj ne kohe Ortakut te vetem per ti shqyrtuar ato dhe miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

NENI 20

Nxjerrja e rezultateve te BILANCIT vjetor,duhet bere me saktesi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre te sistemit te Tatim Taksave qe jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subjekt privat qe ushtron veprimtari tregtare.

NENI 21

BILANCI Kontabel vjetor,miratohet mbi bazen e VENDIMIT me shkrim nga ana e Ortakut te vetem,ne te cilin ai jo vetem qe dokumenton aprovimin e tij por dhe qe percakton dhe ne lidhje me disponibilitetin e FONDEVE ligjore,sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te Shoqerise por dhe per GARANTIMIN e veprimtarise se rregullt te saj,duke patur parasyesh Fondin e Akumulimit,krijimin e fondit te veçante etj.

NENI 22

Te ARDHURAT neto (DIVIDENTI) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e çdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave ose ekzekutimin e detyrimeve(debive) ndaj te treteve,i kalojne ne PRONESI,Ortakut te vetem.

NENI 23

SHPERNDARJA ose Prishja e SHOQERISE,mund te behet ne çdo kohe dhe per çfare do shkak,edhe para plotesimit te AFATIT per te cilen eshte krijuar Shoqeria siç mund te jene:

a.HUMBJA e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

b.Ne nje nga menytrat e parashikuara nga Ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"..

Ne kete rast Ortaku i vetem,merr VENDIM me shkrim ne te cilin parashikon dhe menyren e LIKUDIMIT te Shoqerise,duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e Likuidatorit dhe emertesën SHTESE "Shoqeri ne likuidim e siper."

NENI 24


Akti i EMERIMIT te Likuidatorit,PUBLIKOHET sipas kushteve qe parashikon Ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne ANEKSIN e rregjistrimit Tregtar.

NENI 25

LIKUIDATORI eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korekt si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cilave Shoqeria eshte Kreditore dhe per ekzekutimin e plote te detyrimeve (debive) qe Shoqeria ka ndaj shtetit,shtetasve te veçante apo personave fizike ose juridik vendas apo te huaj.

NENI 26

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise





07.

si rregull dhe pergjithesisht Ortaku i Vetem duhet ta zgjidh ne mirekuptim,ne te kunderten ceshtjen mund ta beje objekt Konflikti gjyqesor ne Gjykatën e Shkalles se pare Durres ose Gjykatën Nderkombetare te Gjeneves.

NENI 27

Persa nuk eshte shprehur ne kete STATUT i referohet udhezimeve plotesuese e konform akteve ligjore e nenligjore ne fuqi,te dhena nga ana e Ortakut te vetem si dhe hapsirave juridike lejuese te Legjislacionit ne fuqi.

NENI 28

Ky STATUT u redaktua ne 5 kopje ne gjuhen shqipe dhe me permbajtje e vlera te njejta juridike dhe pasi MIRATOHET ne parim dhe nen per nen nga une ORTAKU i vetem dhe themelues i Shoqerise tregetare "E R - A R CONSTRUCTION "Shpk Durres- Albania ,nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke u vene emri,mbiemri dhe firma origjinale,autenticiteti i te cilave vertetohet dhe nga NOTERI..

THEMELUES DHE ORTAK I VETEM I SHOQERISE

"E R- A R CONSTRUCTION" Shpk

MIRATUES i ketij STATUTI

Ing. MAKSIM CAMI